



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/106
Datë: 09.11.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 dhe nenin 50 paragrafi 2. të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për Transformim Digjital, në qëllim të mbikëqyrjes dhe sigurimit të mbarëvajtjes së suksesshme të procesit të transformimit digjital brenda institucioneve qeveritare të Republikës së Kosovës.
2. Anëtarët e përhershëm të Komisionit Ekzekutiv janë:
 - 2.1. Kryeministri, kryesues;
 - 2.2. Zëvendës kryeministri i parë, zëvendës kryesues;
 - 2.3. Ministri i Punëve të Brendshme, anëtar;
 - 2.4. Ministrja e Ekonomisë, anëtare;
 - 2.5. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar;
 - 2.6. Lulëzon Jagxhiu, Këshilltar i Kryeministrit për çështjet e Teknologjisë së Informacionit, anëtar.
3. Përgjegjësitë e Komisionit për Transformim Digjital janë:
 - 3.1. Shqyrtimi dhe miratimi i prioriteteve strategjike dhe iniciativave të politikave të reja të Qeverisë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe digjitalizimit;
 - 3.2. Shqyrtimi i zbatimit të strategjive në fushën e teknologjisë së informacionit dhe digjitalizimit;
 - 3.3. Ofrimi i drejtimit strategjik dhe koordinimit ndërinstytucional në projektet me rëndësi të lartë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe digjitalizimit;
 - 3.4. Shqyrtimi dhe miratimi i financimit të prioriteteve strategjike dhe iniciativave në fushën e teknologjisë së informacionit dhe digjitalizimit;
 - 3.5. Shqyrtimi i çështjeve tjera në fushën e teknologjisë së informacionit dhe digjitalizimit.
4. Komisioni për Transformim Digjital, mund të themelojë grupe punuese për trajtimin e çështjeve specifike të domosdoshme, në qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë nga par.3. i këtij Vendimi.
5. Kryesuesi mund të ftojë për pjesëmarrje Ministra tjerë, sipas nevojës.
6. Në cilësinë e pjesëmarrësve të Komisionit Ekzekutiv, pa të drejtë vote, mund të marrin pjesë edhe ekspertët dhe përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare e donatorë tjerë, me kërkesë të Kryesuesit.

7. Vendimet e Komisionit merren me shumicë votash të anëtarëve me të drejtë vote, sipas par.2 të këtij Vendimi. Anëtarët me të drejtë vote janë të gjithë anëtarët e përhershëm të Komisionit.
8. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë